

Deklarata politike nga “Iniciativa Qytetare për Novobërdën”

Deklarata Politike nga “Iniciativa Qytetare për Novobërdën” (IQN), është formuar si rrjedhojë e shumë proceseve politike të njëpasnjëshme të cilat kanë degraduar skajshmërisht themelin e kulturës dhe identitetin e vlerave historike të çdo banori në komunën e Novobërdës dhe vet Qytezës së vjetër.

IQN, është formuar nga figura intelektualesh dhe profesionist të fushave të ndryshme, me synim të rikthimit të vlerave kulturore dhe historike për Qytezën e vjetër të Novobërdës në njërin anë, ndërsa anën tjetër të ofron një platformë konkrete politike që garanton perspektiv për çdo banorë të Komunës së Novobërdës duke ofruar një ide qeverisëse të drejtë për një shoqëri të hapur përballë sfidave dhe problemeve që rëndojnë qytetarët tash e sa vite.

IQN, synim parësor brenda platformës së saj ka:

1. Ofrimin e kushteve optimale për një jetesë të mirë ndaj çdo qytetari të komunës së Novobërdës, duke i garantuar: Punësim, Transport publik, arsim cilësor dhe shërbim shëndetësor 24 orë;
2. Rikthim të vlerës në Qytezën e vjetër të Novobërdës, me një plan konkret infrastrukturor e transport publik me moton: Gjitha rrugët të dërgojnë në Qytezën e vjetër të Novobërdës;
3. Hapjen e shkollave të reja profesionale brenda Qytezës së Novobërdës, me një kampua universitar, veçanërisht në fushën e mineraleve, arkeologjisë dhe hotelerisë;
4. Thithjen e investimeve të huaja duke shndërruar Qytezën e vjetër të Novobërdës në një atraksion të investimeve Bio.

*Pa një zë të drejtë, nuk ka qeverisje të mirë!